

VENDIM
Nr.692, datë 21.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
BASHKIA CËRRIK TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Cërrik të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 4 (katër), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Cërrik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Bashkia: Cërrik										
Nr.	Nr. i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK), shtrirja gjeografike EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1404	EP Xherie	Pisha e Rafinerisë	1/a	Tokë me bim.pyjore	10.00		M.M.P.A.U.	D.SH.P Elbasan	
2	1405	EP Xherie	Selvia e Rafinerisë	1/b	Tokë me bim.pyjore	2.00		M.M.P.A.U.	D.SH.P Elbasan	
2	1405	EP Xherie	Selvia e Rafinerisë	1/b	Zyra sektori	0.05		M.M.P.A.U.	D.SH.P Elbasan	Shkatërruar
2	1405	EP Xherie	Selvia e Rafinerisë	1/b	Depo helmesh	0.0126		M.M.P.A.U.	D.SH.P Elbasan	Shkatërruar

Njësia e qeverisjes vendore: bashkia Bashkia Cërrik

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1404 - 1405	Pyje, kullota, të tjera	Në pronësi